

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papa Leone XIV në Francë/ Mesazhe për migrantët dhe të rinjtë. 700 mijë besimtarë në meshën në Paris, më pas drejt Lourdes
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/26/papa-leone-xiv-ne-france-mesazhe-per-migrantet-dhe-te-rinjte-700-mije-besimtare-ne-meshen-ne-paris-me-pas-drejt-lourdes/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:05:36 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	26 shtator 2026, 15:03:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 26 shtator 2026, 15:02:00 UTC → 26 shtator 2026, 15:04:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	729792a5a38d1a289884a9f9af3091ba796389d26924bd17d5068459218eb8ab
TEKSTI	3b4f322e8149342fd47148995f85edaae8f044495b334995a315784b7e6c5cbc
PAMJA	27e45518a5b5d3eca77d4a15b8e90a7383c319810c7d60f6ff132ee0fa111fbb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5d533aefd66c1a6917cf249a784be095042ca25bf47effb87a4046b88cafcc31
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5d533aefd66c1a6917cf249a784be095042ca25bf47effb87a4046b88cafcc31>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA TË FUNDIT

Papa Leone XIV në Francë/ Mesazhe për migrantët dhe të rinjtë. 700 mijë besimtarë në meshën në Paris, më pas drejt Lourdes

26/09/2026 17:03



Papa Leone XIV vijon vizitën e tij apostolike në Francë. Në ditën e dytë të qëndrimit në vend, të shtunën më 26 shtator, kreu i Kishës Katolike zhvilloi disa takime në Paris, përpara se të udhëtonte drejt Lourdes, një prej vendeve më të rëndësishme të pelegrinazhit katolik.

Gjatë paradites, Papa vizitoi qendrën e pritjes "Maison Bakhita", ku u takua me komunitetin e migrantëve. Më pas ai zhvilloi një takim me katekumënët, të rritur që po përgatiten për të marrë sakramentin e pagëzimit.

Në orët e pasdites, Leone XIV kremtoi meshën në Place de la Concorde, ku ishin mbledhur rreth 700 mijë besimtarë. "Maison Bakhita" është një projekt i nisur në vitin 2018 nga Kryedioqea e Parisit, në kuadër të përpjekjeve për pritjen dhe integrimin e migrantëve.

Gjatë takimit, Papa iu referua Shën Bakhitës, ish-sklaves sudaneze që u shpall shenjtore, duke vënë në pah rolin e grave në ndërtimin e një "qytetërimi të dashurisë".

Leone XIV falënderoi të gjithë ata që punojnë në qendër dhe theksoi rëndësinë e krijimit të hapësirave ku njerëzit mund të gjejnë mbështetje, besim dhe shpresë.

"Askush nuk është aq i varfër sa të mos ketë diçka për të dhënë; askush nuk është aq i pasur sa të mos ketë diçka për të marrë", u shpreh Papa.

"Jam i befashuar nga numri i të rriturve që kërkojnë pagëzimin"

Më pas, Papa u takua me katekumënët në Institutin Katolik të Parisit. Ai tha se ishte i befashuar nga numri i njerëzve që po i afrohen sërish besimit dhe veçanërisht nga numri i të rriturve që kërkojnë sakramentet e inicimit të krishterë.

Leone XIV vuri në dukje se kjo dukuri është veçanërisht domethënëse në një shoqëri franceze të karakterizuar nga një nivel i lartë sekularizimi.

Sipas tij, përvoja e këtyre njerëzve është një dëshmi i gjallë e asaj që ai e cilësoi si veprimin e hirit të Zotit, përtej analizave statistikore dhe sociologjike.

Rritje e numrit të pagëzimeve në Francë

Sipas të dhënave të Konferencës Ipeshkvnore Franceze, gjatë Pashkëve të këtij viti në Francë u pagëzuan 21,386 katekumënë, prej të cilëve 13,234 të rritur dhe 8,152 adoleshentë.

Numri i përgjithshëm është rritur me rreth 20% krahasuar me vitin 2025. Rritja është veçanërisht e dukshme te të rriturit, me rreth 28%, ndërsa te adoleshentët është rreth 10%.

I Kryesore



Nga mbrojtja e rritja ekonomike te lufta kundër grupeve kriminale transnacionale, Ambasada Amerikane tregon prioritetet e ambasadorit të ri të Trump në Tiranë

15:54

Aksidenti i rëndë në Thumanë, tre mjete përplasen me njëra-tjetrën, humb jetën një 19-vjeçar, plagosen dhe dy persona

07:38

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë për arrestimin e personave me rrezikshmëri të lartë, një në pranga, Endrit Dokle shpallet sërish në kërkim

10:57

Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë shqiptar

07:59

Teherani ofroi armëpushim 7-ditor, Wall Street Journal: Trump e refuzoi dhe kërkoi që bombardimet ndaj Iranit të vijojnë pas zgjedhjeve të nëntorit

08:12

I Më të lexuarat

Pushimet kthehen në tragjedi, motër e vëlla nga Shqipëria dhe partnerët e tyre humbin jetën pas shembjes së godinës në Athinë

Fusha kthehet në ring! Lukaku bën gjestin e turpshëm ndaj italianëve, Donnarumma humb toruan dhe vërsulet drejt tij

Shpërthimi i fuqishëm në Athinë ku humbën jetën 3 shqiptarë, ekipet e emergjencës nxjerrin trupat e 6 viktimave nga rrënojat

Berisha pa ftesë për ceremoninë e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, kreu i PD: Nuk jam ftuar as për mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare

U arrestua me urdhër të SPAK, kush është 50-vjeçari që njihet si "i forti i Shkodrës", pjesë edhe e grupit 'Raja'

Ish-agjenti i CIA u sugjeron amerikanëve të jetojnë në Shqipëri, Bustamante: Nëse do të doja të zhvendosesha në Evropë, Shqipëria do të ishte në radarët e mi

Detaje/ Atentati në Athinë ku mbeti e plagosur 10-vjeçarja shqiptare, urdhri u dha nga i burgosuri 'i famshëm', babai i të miturës pronar i lokalit

Atentat në Athinë, katër persona hapën zjarr drejt një kafeneje, plagoset një fëmijë

Papa u bëri thirrje komuniteteve katolike që këte rikinim të të rinjve dhe të rinurve të besimi ta shoqërojnë me formim të përshtatshëm shpirtëror.

700 mijë besimtarë në Place de la Concorde

Më pas, Papa Leone XIV u prit nga një turmë e madhe besimtarësh përgjatë Champs-Élysées, nga Harku i Triumfit deri në Place de la Concorde, ku u zhvillua mesha.

Reeth 700 mijë persona morën pjesë në ceremoninë fetare, ndërsa shumë prej tyre e pritën Papën duke valëvitur flamuj dhe duke kënduar himne.

Gjatë meshës, Leone XIV iu drejtua veçanërisht të rinjve. "Ju jeni Kisha e sotme", u tha ai, duke vlerësuar entuziazmin dhe energjinë e tyre.

"Mos e mbani besimin vetëm për veten"

Në fjalën e tij, Papa u bëri thirrje katolikëve francezë që të mos e jetojnë besimin vetëm në mënyrë private.

Ai i ftoi ata të rizbulojnë besimin dhe ta shndërrojnë atë në një burim shprese për shoqërinë.

"Mos e mbani besimin në Jezu Krishtin vetëm për veten tuaj, por lëreni të rrjedhë për të ushqyer dhe mbushur me shpresë njerëzit që takoni", tha Leone XIV.

Ai shtoi se besimtarët duhet të çojnë shpresën "aty ku mbizotëron dekurajimi dhe thatësia shpirtërore".

Më pas, Papa udhëton drejt Lourdes

Pas përfundimit të programit në Paris, Papa Leone XIV u nis drejt Lourdes, në jugperëndim të Francës.

Atje ai do të vizitojë shenjtëroren e famshme mariane dhe do të drejtojë lutjen pranë shpellës ku, sipas traditës katolike, Shën Bernadeta Soubirous përjetoi shfaqjet e Virgjërshës Mari.

Vizita në Lourdes është një nga momentet kryesore të udhëtimit apostolik të Papës në Francë.

Personalitetet e pranishme në Paris

Në mesin e personaliteteve që morën pjesë në ceremoninë në Paris ishin ish-presidenti Nicolas Sarkozy, presidenti i republikanëve Bruno Retailleau, presidentja e rajonit Île-de-France Valérie Pécresse, ish-kryeministri François Fillon, Gabriel Attal, Dominique de Villepin dhe Eric Zemmour.

Ndërkohë, ishin parashikuar të merrnin pjesë edhe ish-kryeministri Édouard Philippe, Marine Le Pen dhe kryeministri aktual Sébastien Lecornu.

Presidenti Emmanuel Macron nuk mori pjesë në meshën e zhvilluar nga Papa, pasi Presidenca franceze kishte njoftuar më herët se ai nuk do të ishte i pranishëm në asnjë prej meshave të kësaj vizite.

Top Channel

I Bota »



Moti i keq përmyt Bankokun, autoritetet shpallin gjendje katastrofe në të gjitha distriktet e kryeqytetit tajlandez

26/09 09:23



Pasojat e luftës Iran-SHBA, BE i bën thirrje shteteve anëtare: Merrni masa për uljen e kërkesës për gaz dhe energji elektrike

26/09 08:50



Houthit sulmuan me raketa e dronë Arabinë Saudite, reagon Këshilli i Sigurimit të OKB: Sulmi ndaj popullsisë civile është i papranueshëm

26/09 08:38



shqiptar

"Disa histori i kam jetuar, të tjera...", çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri, publikon videon 'enigmatike': Kam shumë për të thënë

Trinjaket nisin universitetin, tre motra nga Kukësi zgjedhin farmacinë për të qëndruar bashkë edhe në auditorë



Houthit shënjestrojnë sërish Arabinë Saudite, mbrojtja ajrore shkatërron dy dronë dhe dy raketa që po shkonin drejt Riadit dhe Khamis Mushait

26/09 08:25



Teherani ofroi armëpushim 7-ditor, Wall Street Journal: Trump e refuzoi dhe kërkoi që bombardimet ndaj Iranit të vijojnë pas zgjedhjeve të nëntorit

26/09 08:12



Armëpushim 7-ditor dhe hapje të Ngushticës së Hormuzit/ Teherani i dërgon propozimin Uashingtonit: Topi është në fushën e SHBA-së

26/09 07:50

Na ndiqni:



I Video »



Top News – 'Paturpësi ekstreme' / Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Biden për dënimin e Thaçit, i pabesë



Top News – 'Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë' / Berisha: Për të qëndruar në pushtet



Top News – 'Rama është armik i egër i Kosovës', Berisha: Po përhap shpifje të ulta kundër LVV



Top News-Foltoret e Ripërtëritjes në Vlorë dhe Elbasan/Berisha: Orteku i opozitës po rritet çdo ditë



Top News – 'Vlora Hyseni po u jep reston' / Berisha: Po i kthehet bashkëpunëtorëve që e tradhtuan



Top Channel/ Zjarr në kuzhinën e hotelit në Gjirokastrë, si u shmang një incident më i madh

Lajme	Bota	Sport	Pop News	Programe	Top Channel
Lajmet e fundit	Opinion	Kombëtarja	Showbiz	Big Brother VIP	Rreth Top Channel
Politikë	Koment	Kategoria Superiore	Lifestyle	Për'puthen	Kontakt
Kronikë	Kosova dhe Rajoni	Kategoria e Parë	Fashion	Shqipëria LIVE	Bileta – Portokalli
Aktualitet	Shkencë dhe Teknologji	Premier League	Shëndeti	Fiks Fare	Puno në Top Channel
Ekonomi	Auto	La Liga	Dieta	Video	Privacy Policy & Terms of Use
Sociale		Serie A	Receta gatimi	Të gjitha programet	Aksesueshmëria
Video		Shumësportësh		Guida TV	
Top News LIVE		Sport Gossip			

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.